

AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“ODDYSEUS INVESTMENT” SHPK

Date 04.10.2021

Alban Qazimi, lindur në Tiranë, **lindur në Tiranë me 25.01.1972**, banues në adresën: **Rruga “Ymer Kurti”, Nd.8, Hyrja 3, Ap. 25, Tirane, me Nr. Personal 036543520** madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, bazuar ne Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” vendosa te themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“ODDYSEUS INVESTMENT” SHPK**, sipas parashikimeve te mëposhtme:

NENI 1

Emri i shoqërisë

Emërtimi i Plotë i Shoqërisë Tregtare është **“ODDYSEUS INVESTMENT” SH.P.K.**

NENI 2

Selia e shoqërisë


Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë në adresën adresën Rruga “Kongresi i Lushnjes”, Pallati 39, Shkalla 2, Tirane

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- (a) Ushtimin e veprimtarive tregtare në fushën e hoteleri – turizmit nëpërmjet studimit, planifikimit, zhvillimit, menaxhimit, konsulences dhe vënies në funksion të të gjitha kapaciteteve logjistike dhe njerëzore në përmbushje të kësaj veprimtarie.



- (b) Pjesëmarrje në veprimtari tregtare të fushës së hoteleri-turizmit, në formën e investimit, menaxhimit, operimit, konsulencës, operacioneve tregtare të blerjes apo shitjes së pasurive të paluajtshme
 - (c) Kryerja e çdo veprimtarie të ligjshme të ngjashme ose plotesese në funksion të fushave të veprimtarisë të referuara në pikat 4.1(a, b, c) të këtij Statuti.
- 4.1 Shoqëria mund të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative në *consortium*-e edhe të përkohshme, *joint venture* ose të zotëroje, të blejë ose të shesë kuota apo aksione në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të, jo si aktivitet parësor, Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.
- 4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronat e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

NENI 4 **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributet e ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në të holla me vlerën 100 (njëqind) LEKË. Kapitali themeltar ndahet në 1 kuotë, e barabartë me 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Kapitali themeltar do të shlyhet nga ortaku themelues në llogarinë bankare të Shoqërisë, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Një kopje e mandat pagesave bankare të shlyerjes së kapitalit themeltar nga ana e Ortakut të Shoqërisë, depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit si deklaram vullnetar nga Administratori i Shoqërisë.

NENI 5 **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



NENI 6 Organet Drejtuese

Ne zbatim te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë vijon :

1. Asambleja e Përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

Mënyra e organizimit dhe funksionimit te ketyre organeve rregullohet dhe ushtrohet sipas parashikimeve të Statutit te Shoqërisë dhe legjislacionit ne fuqi.

Shoqëria do të perfaqësohet ligjërisht nga Administratori i saj e cila është **znj.Isida Kora**, e datëlindjes 17.03.1974 lindur dhe banuese në Tiranë në adresën Rruga “Vllazen Huta” Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Nr. Personal H45317063U

NENI 7 Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Me nënshkrimin e ketij Akt Themelimi, ortaku themelues detyrohet qe te hartojë dhe nënshkruajë Statutin e Shoqërisë, një kopje e te cilit do te depozitohet ne QKB.

Ngarkohet Ortaku ose Administratori i Shoqërisë që të kryejnë procedurat e Rregjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit. Këtë detyrim, ata mund ta kryejë personalisht, ose përmes personave të caktuar prej tyre me Autorizim ose Prokurë të Posaçme.

Ortaku Themelues

ALBAN QAZIMI

Alban Qazimi

